




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 39 paragrafi 1.4, në nenin 49 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 02.03.2012 miratoi këtë

VENDIM

Për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i realizimit të të hyrave të planifikuara nga viti 2011 dhe bartja e tyre në vitin fiskal 2012

I

Me këtë vendim lejohet rritja e buxhetit nga tejkalimi i realizimit të të hyrave të planifikuara nga viti 2011 dhe bartja e tyre në vitin fiskal 2012 .

II

Mjetet e tejkalimit të realizimit të të hyrave të planifikuara të vitit 2011 në shumë prej **269.242,67€** barten në:

1. Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej **134.242,67€** Mallra dhe Shërbime,
2. Programi 920 Arsim dhe shkencë (nënprogrami Administrata e arsimit 92135) në shumë prej **135.000.00 €** Mallra dhe Shërbime,

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-23618
Gjilan, më 02.03.2012

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues